

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-152/13

Prishtinë, 12 mars 2014

Në çështjen juridike të:

N P B

P

Pala ankuese

kundër

G D J

Ll

P

Paraqitësja e kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Kryetare e Kolegjit e EULEX-it Esma Ertezi, gjyqtar i EULEX-it Willem Brouwer dhe gjyqtari Sylejman Nuredini, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/C/139/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA10234), i datës 07. dhjetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 12. mars 2014, morri këtë:

AKTGJYKIM

Hedhet si e papranueshme ankesa e N P B, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/139/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA10234), i datës 07. dhjetor 2011.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 20. tetor 2006, G Dj ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së pronësisë në lokalitetin afarist që gjendet në Prishtinë, në rrugën "Ilir Konushevc" të ngastrës nr. 7702/2 në sipërfaqe prej 69 m². Ajo ka shpjeguar se objekti afarist është pronë e saj, dhe i cili objekt është uzurpuar nga persona të panjohur. Objekti afarist është humbur si rezultat i rrethanave në vitet 1998/1999 dhe se data e humbjes është 1. qershor 1999.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Pajtimi gjyqësor i arritur në mes të G Dj (paraqitësi i kërkesës) dhe ndërmarrjes "Z.L", i cili ishte pjesë përbërëse e seancës gjyqësore kryesore e Gjykatës Komonale në P C.nr.766/01 i datës 29. shtator 2006, me të cilin është vendosur se paraqitësi i kërkesës është pranuar e drejta e pronës (në 1/1) mbi pronën e paluajtshme të ngastrës 7702/2 që gjendet në rrugën "Ilir Konushevc" në Prishtinë, në sipërfaqe prej 0.00.69 ha, me objektin e paregjistruar në at ngastër të Ndërmarrjes "Z L" nga P.
 - Fleta poseduese nr. 10011 e datës 11. prill 2003 të lëshuar nga Shërbimi Kadastral i Pronës së Paluajtshme në Prishtinë.
 - Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL.nr.71914059-11697 të lëshuar nga Zyra e Kadastrit të Komunës së P e datës 26. tetor 2007 me të cilën konstatohet se paraqitësi i kërkesës është pronarë e ngastrës kadastrale 7702-2 në sipërfaqe prej 69 m², që gjendet në rrugën "Ilir Konushevc" në Prishtinë;
 - Letërnjoftimi i paraqitësi i kërkesës i lëshuar nga UNMIK-u me datë 8. tetor 2001, me nr. 1501415720.
3. Prona e kërkuar e regjistruar sipas kërkesës KPA10234 është notifikuar me datë 25. prill 2008, dhe me 17. gusht 2010, atëherë kur njësitit i njoftimit të AKP-ës kishte shkuar në vendin ku gjendej lokali afarist i cili është objekt i pretenduar i kërkesës dhe kishin vendosur njoftimet së prona ishte objekt kërkesë dhe që palët e interesuara duhej që t'i paraqitnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Me rastin e vizitës Ekipi i notifikimit ka konstatuar se prona e pretenduar ka

- qen e uzurpuar nga E K i cili ka deklaruar se pretendon të drejtën pronësore mbi këtë objekt afarist.
4. Pala përgjegjëse E K, i ishte bashkangjitur procedurës në bazë të shkresës së tij të datës 25. prill 2008, duke theksuar se ai ishte shfrytëzuesi i lokalit afarist por ai nuk ka parashtruar ndonjë përgjigje dhe ndonjë dokument për ta mbështetur kërkesën e ti.
 5. Njësitë verifikues i AKP-ës ka verifikuar pozitivisht marrëveshjen gjyqësore të arritur në Gjykatën Komunale të Prishtinës, C.nr.766/01, të datës 29. shtator 2006, si dhe Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL.nr.719140059-11697 të lëshuar nga Zyra e Kadastrit të Komunës së P e datës 26. tetor 2007 .
 6. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronën e kërkuar, me vendimin e tij KPCC/D/C/139/2011, i datës 07. dhjetor 2011, i ka pranuar paraqitëses së kërkesës të drejtën e pronës në lokalin afarist që është objekt i kërkesës duke ia kthyer në posedim. Vendimi është bazuar në pajtimin gjyqësor të arritur në procedurën gjyqësore para Gjykatës Komunale të P, C.nr. 766/01, të datës 29. shtator 2006. Sipas këtij pajtimi gjyqësor G Dj i është njohur e drejta e pronësisë në këtë objektin komercial.
 7. Me 30. prill 2012 paraqitëses së kërkesës i është dorëzuar vendimi i KKPK KPCC/D/C/139/2011, i datës 07. dhjetor 2011.
 8. Me 24. maj 2013, N P B ka paraqitur ankesë kundër vendimit të Komisionit KPCC/D/C/139/2011, të datës 07. dhjetor 2011.
 9. Ankesën e ka pranuar pala përgjegjëse në kërkesë (palë e interesuar) E K me datë 18. shtator 2013, kurse paraqitësja e kërkesës (pala përgjegjëse ne ankesë) e pranoi ankesën me datë 17 shtator 2013, por asnjëri nuk paraqiti përgjigje në ankesë.

Arsyetim ligjor:

Pretendimet e palëve

10. Në ankesë e tij theksohet se vendimi ankimor është marr me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe me aplikim të gabuar të ligjit material, me propozim që vendimi i Komisionit të ndryshohet dhe të vërtetohet se lokali afarist që gjendet në Prishtinë në rrugën “Lidhja e Prizrenit” në sipërfaqe prej 40 m² është i ankuesit.
11. Kjo ngase sipas aktvendimit të Sekretariatit për Urbanizëm, Pune komunale dhe të Banesave në Prishtinë 08.nr.351-66 i datës 26. maj 1976 i është lejuar paraardhësit të sajë juridik N së B të vendos lokalet e tipit montazhe. Ndërkaq, sipas aktvendimit të Sekretariatit për Urbanizëm,

Punë komunale dhe të Banesave në Prishtinë 08.nr.353-176 i datës 14. korrik 1977 ish B V të I i është dhënë leja e përdorimit dhe shfrytëzimit të këtyre lokaleve.

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është e palejueshme (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) pasi që pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë.
13. Kjo ngase sipas dispozitës së nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079), pala mund të paraqes ankesë brenda (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës mbi vendimin e Komisionit për kërkesën. Po ashtu, sipas dispozitës së nenit 176.par 1 dhe 177.par 1 të LPK-ës parashikohet që e drejta për të paraqitur ankesë është e drejtë ekskluzive palëve të procedurës së shkallës së parë.
14. Prandaj sipas nenit 10.1 (neni 13.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) parashikohet se palë në kërkesë dhe në procedurën e përafërta është “çdo person, përveç paraqitësit kërkesës, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë [...], me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive [...]”.
15. Nuk është kontestuese se pala ankuese nuk ka qenë palë dhe nuk ka marr pjesë në procedurën e shkallës së parë pranë KKPK-së. Pala ankuese nuk ka dhënë shpjegime dhe sqarime të drejta të plota dhe juridikisht të vlefshme për shkaqet të justifikueshme të arsyeshme që e kanë penguar dhe pamundësuar pjesëmarrjen në këtë procedurë e me qëllim që tani të pranohet si palë në këtë procedurë.
16. Gjykata vëren se njoftimi është kryer siç duhet. Ekipi i AKP-së ka vendosur-afishuar shenjen informuese në tri gjuhët – shqip, serbisht dhe anglisht në pronën e paluajtshme që është objekt i kërkesës.
17. Ankuesi nuk ka paraqitur shkaqe juridikisht të vlefshme të arsyeshme dhe të justifikueshme për ta informuar AKP-në për qëllimin e tij për të marrë pjesë në procedurë, gjë që detyrimisht është dashur të vepronte kësisoj. Kjo aq më tepër, ngase ankuesi si person juridik ka qen i detyruar në kuadër të fushë veprimtarisë së tije mbi bazën e kujdesit dhe vlerësimit afarist t'i ndërmarr të

gjitha veprimet juridikisht të drejta dhe të ligjshme për kujdesin dhe shtimin e vlerës së N P B në cilësinë e ankuesit. Pasi që ai nuk ka arsytim se përse nuk kishte marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë pranë AKP-së, ky dështim shkon në dëm të tij.

18. Pasi që ankesa është e palejueshme, Gjykatës Supreme nuk i lejohet që të vendos për meritat e ankesës përkatësisht vendimit.
19. Ndonëse objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit ishin pretendimet e ankuesit për pranimit të së drejtës së pronës dhe kthimit në posedim të objektit komercial që gjendet në rrugën "L e P në sipërfaqe prej 40 m², por gjeti se nuk ekziston identiteti objektiv dhe subjektiv në ankesës dhe vendimint të kundërshtuar. Kjo ngase paraqitëses së kërkesës me vendimin ankimor i është pranua e drejta e pronës në ngastrë kadastrale 7702-2 në sipërfaqe prej 69 m² që gjendet në rrugën "Ilir Konushevcu në Prishtinë.
20. Prandaj, ankesa hedhet poshtë si e palejueshme (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe neni 195.1 nen paragrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme.

Esma Ertezi, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Willem Brouwer, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nuffer, Referent i EULEX-it